



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:273606
Datë: 09.11.2023
Numri i dokumentit: 04898626

C – IV – 14 – 6635

Paditësi :

J M nga fshati R i Komunës së Ferizajit, i përfaqësuar nga av.D B nga Ferizaj.

Kundër

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lagja, "Lakërishtë" Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me **dt.09.11.2023**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. PRANOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, J M nga fshati R i Komunës së Ferizajit, dhe **NDRYSHOHET** Vendimi, GJI057- 0193 i dt.16.07.2013 i Autoritetit të Likuidimit (AL) pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), si dhe **OBLIGOHET**, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit (AL), që paditësit, t'ia kompensoj pagat e pa paguara në shumën prej **1,241,00 € (një mijë e dy qind e dy zetë e një)** për periudhën Maj – Tetor 1990 si dhe kamatën ligjore, si kërkesë aksesore në lartësi prej 10 %, e në shumën prej prej **124.10 € (një qind e një zetë e katër eurove e dhjetë centë)** për detyrimin kryesor dhe atë me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

II. REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, J M nga fshati R i Komunës së Ferizajit lidhur me kërkesën e tij për kamatë vjetore sipas ligjit prej muajit prill 2006 e deri në pagesën definitive.

III. DETYROHET, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit (AL), që paditësit, J M nga fshati R i Komunës së Ferizajit, i përfaqësuar nga av.D B nga Ferizaj, t'ia kompensoj shpenzimet procedurale

dhe atë në emër të pagesës së taksës gjyqësore, shumë prej 21,00 €, në emër të përpilimit të për ankesës/padiës, shumë prej 104,00 € dhe në emër të përpilimit të Përgjigjjes në mbrojtje në shumë prej 104.00 € e në totalin e tyre prej **229.00 € (dy qind e njëzet e nënëtë)**.

Rrethanat Procedurale dhe Faktike :

Paditësi së bashku me punëtorët tjerë të ish NSh, "Fabrika e këmbyesve të nxehtësisë", "FAKNIT" me seli në Ferizaj e tani NSh, "Eurometali" me seli në Ferizaj, me dt.04.02.1991, fillimisht në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, kanë paraqitur propozimin për pagimin e të ardhurave personale derisa në muajin gusht 2013, kanë parashtruar në këtë gjykatë padinë e përbashkët, e evidentuar, C – IV – 13 - 1564, por më pas duke vepruar sipas Urdhrit të dt.11.09.2014, të kësaj gjykate, kanë parashtruar ankesa/padi të veçanta përmes dërgimit me postë me dt.15.10.2014, e tani të evidentuar, C – IV - 14 – 6663 dhe atë kundër Vendimit, GJI057- 0193 i dt.16.07.2013 të Autoritetit të Likuidimit (AL) pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) lidhur me NSh, "Eurometali" në likuidim me seli në Ferizaj, e me të cilin, paditësit, i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e tij për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën maj – tetor 1990 në shumë të përgjithshme prej 1.241.00 € e me kamatë vjetore sipas ligjit prej muajit prill 2006 e deri në pagesën definitive.

Paditësi në këtë padi ka theksuar se ka qenë në marrëdhënie të përhershme pune në NSh, Fabrika e Këmbyesve të Nxehtësisë "FAKNIT" me seli në Ferizaj, e cila para privatizimit, është emërtuar, NSh, "Eurometali" në likuidim. Paditësi pretendon se pa bazë ligjore nuk i janë paguar të ardhurat personale prej muajit maj – të vitit 1990 e në ndërkohë paditësi dhe punëtorët tjerë kanë qenë të larguar nga puna me një vendim arbitrar e të kundërligjshëm nga Këshilli i Përkohshëm i Ndërmarrjes, dhe se paditësi ka ushtruar padi në Gjykatën kompetente kundër aktvendimit mbi largim nga puna dhe për pagesën e pagave përfshirë pagesën e pagave të papaguara, tani lëndë të pavendosura në Gjykatën Themelore në Ferizaj, padia e paditësit nuk është zgjidhur në mënyrë meritore dhe se nuk është kontestues fakti se kanë punuar dhe nuk janë paguar nga muaji maj - tetor 1990, dhe se ky fakt është vërtetuar me shkresën zyrtare të NSh, "Fabrika e Këmbyesve të Nxehtësisë", e tani NSh "FAKNIT" me seli në Ferizaj të dt.06.05.1991 dhe 07.05.1991, e më tej shton së shkresat tregojnë bazueshmërinë e kërkesës për pagesën e pagave të papaguara, që rezulton qartë se Vendimi i AL-së për refuzimin e kërkesës së paditësit është i pabazuar, andaj paditësi i është drejtuar gjykatës që të merr aktgjykim me të cilën aprovohet në tërësi e bazuar kërkesëpadi, të detyrohet, NSh "Eurometali" me seli në Ferizaj (në likuidim), që paditësit në emër të pagave të papaguara për muajt Maj – Tetor 1990, t'ia paguaj shumë prej 1.241.00 €, e me kamatë vjetore nga viti 2006, dhe shpenzimet e procedurës.

Paditësi padisë së tij, ia ka bashkangjitur provat gjegjëse në kopje të tyre: autorizimin gjegjës, kërkesën për lirimin nga pagesa e taksës gjyqësore, Vendimin e AL-së, GJI057- 0193 të dt.16.07.2013, shkresën e dt.15.10.2024 të av. R A nga Ferizaj të drejtuar në DhPGJSK, Regjistrin, Nr.08 e dt.27.05.2006 e emrave të punëtorëve për realizimin e borxhit të mbetur pranë, NSh "FAKNIT" me seli në Ferizaj për muajt Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, dhe Tetor të vitit 1999, kopjen e propozimit të paditësve të dt.04.02.1991 të adresuar te Gjykata Themelore e Punës së Bashkuar në Prishtinë, kopjen e ftesës për seancë gjyqësore nga Gjykata Themelore e Punës së Bashkuar në Prishtinë, Shkresa, GJ.A.nr.414/2019 e dt.10.05.20213 e Gjykatës Themelore në Ferizaj lidhur me kërkesën e dt.10.05.2013 të Kryetarit të Sindikatës së Pavarur, dhe Shkresën, Nr.114 të dt.07.05.1991 të regjistrin të punëtorëve të paguar dhe të papaguara për vitin 1990 të NSh "FAKNIT" me seli në Ferizaj për muajt, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor të vitit 1990.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, i është drejtuar kësaj gjykate me parashtrësën gjegjëse të dt.18.01.2022 për të proceduar në këtë lëndë e të cilës ia ka bashkangjitur, autorizimin për përfaqësim për av. D B nga Ferizaj derisa me parashtrësës së dt.30.05.2022 të drejtuar kësaj gjykate, ia ka bashkangjitur provat : informatën, nr.3142 të dt.01.10.1990 për NSh "FAKNIT" me seli në Ferizaj nga anëtarët e sindikatës së kësaj ndërmarrje shoqërore, Shkresën Nr.1128 të dt.06.05.1991 lidhur me të ardhurat e pa paguara personale për punëtorët e NSh "Fabrika e këmbyesve të nxehtësisë", "FAKNIT" me seli në Ferizaj për muajt, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor të vitit 1990, kopjen e ftesës, nr.1391 të dt.21.10.1991 të Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, kopjen e një shkresë për dorëzimin e padisë në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, kopjen e përsëritur të propozimit të dt.04.02.1991 të paditësve të adresuar te Gjykata Themelore e Punës së Bashkuar në Prishtinë, Regjistrin,nr.677 të dt.04.07.2002 të emrave të punëtorëve NSh "FAKNIT" me seli në Ferizaj për realizimin e borxhit të mbetur në vitin 1990 për muajt, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator dhe , Tetor, Shkresën e dt.10.05.2013 të Kryetarit të Sindikatës së Pavarur e të drejtuar në AKP – Gjilan, Shkresën e përsëritur, GJ.A.nr.414/2019 e dt.10.05.20213 e Gjykatës Themelore në Ferizaj lidhur me kërkesën e dt.10.05.2013 të Kryetarit të Sindikatës së Pavarur, dhe kopjen e aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac.nr.251/2006 të dt.21.01.2008 lidhur me prishjen e aktvendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, C.nr.716/2006 për shpallje jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, i është drejtuar kësaj gjykate me parashtrësën gjegjëse dt.11.09.2022 e me të cilën e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë me shpenzimet e procedurës, dhe atë në emër të pagesës së taksës gjyqësore, shumën prej 21,00 €, në emër të përpilimit të për ankesës/padiës, shumën prej 104,00 € si dhe shpenzimet tjera të cilat mund të krojohne më vonë.

Me dt.05.10.2023 e paditura, AKP-ja, duke vepruar sipas urdhrit të DhPGJSK-së, C - IV – 14 – 6635 të dt.14.09.2023, ka paraqitur mbrojtjen në padinë e paditësit e në të cilën ka kundërshtuar pretendimet e paraqitura duke i konsideruar të pabazuara në ligj dhe si e tillë të refuzohet, se AL-ja ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar drejtë, se objekt i kësaj procedure, është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin, Nr.04/L – 034 e Vendimit të AL-së, se paditësi nuk ka argumentuar as se cili nen i Ligjit, Nr.04/L – 034, është shkelur nga AL-ja e duke deklaruar vetëm se Vendimi i AL-së, nuk është i bazuar por nuk e ka bashkangjitur të njëjtin vendim, se rregull bazik në procedurën civile kontestimore, se pala kërkuese ka detyrimin dhe barrën e provës (neni 7 i Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe neni 31 i Ligjit, Nr.06/L – 086, si dhe se një rregull e tillë, shprehimisht është e sanksionuar edhe në nenin 23.2.4 dhe 23.3 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për SAKP-në, se e paditura pretendon se paditësi, nuk ka vepruar sipas nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 të AKP-së, i cili parasheh se : *''elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese''*, se AL-ja ka vërejtur se paditësi, nuk e ka paraqitur vendimin e gjykatës, që është kërkuar nëpërmjet kërkesës për informacione shtesë e rrjedhimisht AL-ja, ka konsideruar se dokumentacioni për kërkesën ka mbetur i pa plotë në kuptim të nenit 36.2.2 të Shtojcë së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, dhe për këtë arsye, edhe kërkesën e paditësit e ka refuzuar, se paditësit gjithashtu ka pohuar se kërkesa e tij për rroga të pa paguara është refuzuar nga gjykata e në bazë të këtij pohimi, AL-ja, nuk ka pasur kompetenca ligjore për të vërtetuar

ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave dhe është e detyruar t'i refuzoj kërkesa të tilla n bazë të nenit 36.1 të Shtojcë së Ligjit nr.04/L-034 dhe i ka propozuar DhPGJSK-së, që gjykata të merr

aktgjykim më të cilën refuzohet ankesa si e pa pranueshme dhe e pabazuar dhe të vërtetohet Vendimin i AL-së në pajtim me nenin 36.2 të Ligjit Nr.04/ L - 086 dhe se kësaj mbrojtjeje ia ka bashkangjitur, Vendimin e AL-së, GJI057- 0193 i dt.16.07.2013.

Me Urdhrin e saj, C – IV. – 14 – 6635 të dt.06.10.2023, gjykata ia ka adresuar paditësit, mbrojtjen e të paditurës për përgjigje brenda afatit 7 (shtatë) ditëve, të cilat shkresa paditësi i ka pranuar me dt.11.10.2023 dhe se me dt.17.10.2023, ka paraqitur Përgjigje në këtë mbrojtje e në të cilën në mes tjerash ka theksuar se i kundërshton pretendimet e të paditurës të thëna në mbrojtjen e paraqitur në padinë e paditësit se ankesa e parashtruesit është e pa pranueshme dhe pretendimet e paditësit, janë të parashkruara e duke vënë në pah se ai në pajtim me nenin 74.2, nenin 35 par.1 dhe 2 si dhe nenin 31 të Ligjit, Nr.06/086, ka parashtruar padi/ankesë në DhPGJS, dhe kësaj padie/ankese, i ka bashkangjitur provat gjegjëse e duke u bazuar në provat e bashkangjitura padisë së tij dhe se duke u bazuar në dokumentacionit e bashkangjitur, ka konsideruar se pa dyshim vërtetohet e drejta e tij dhe i ka propozuar DhPGJSK-së, që të merr vendim meritore në dobi të paditësit dhe të obligoj të paditurën, që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 21,00 €, për taksë gjyqësore, dhe shpenzimet e përfaqësuesit të autoritar sipas tarifës së OAK-së ; për ankesë/padi, shumë prej 104,00 € dhe për Përgjigje në mbrojtje në shumë prej 104.00 € e më gjerësisht si në këtë Përgjigje në mbrojtje.

Me dt.26.10.2023, e paditura, AKP-ja, duke vepruar sipas urdhrit të DhPGJSK-së, C - IV – 14 – 6663 të dt.17.10.2023, ka paraqitur Kundërpërgjigje e në të cilën në mes tjerash, ka cekur bazën e njëjtë ligjore siç e ka cekur në mbrojtjen e saj të dhënë në padinë e paditësit e veçmas duke u bazuar në atë se pala kërkuese ka detyrimin dhe barrën e provës (neni 7 i Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe neni 31 i Ligjit, Nr.06/L – 086 si dhe duke e cekur dispozitën e nenit 36 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, që bënë fjalë për kërkesat e pavlefshme dhe jo të rregullta, aty, parashihet se :... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë *se dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese*” e më gjerësisht, si në këtë kundërpërgjigje e me propozimin që gjykata, t'a refuzoj parashtruesin si të pabazuar /apo të pa pranueshme, dhe t'a vërtetoj (lërë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tej Ligji i Dhomës së Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata merr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata vlerësoj se në rastin konkret, kërkesëpadija e paditësit, J M nga fshati R i Komunës së Ferizajit duhet të pranohet pjesërisht si e bazuar për një pjesë të saj kurse për pjesën tjetër e kërkesëpadiisë lidhur me kamatën ligjore, duhet të refuzohet pjesërisht si e pabazuar.

Afatshmëria dhe pranueshmëria e kërkesës së paditësit.

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse, dhe ka konstatuar, se Ndërmarrja Shoqërore, NSh, "Fabrika e këmbyesve të nxehtësisë", "FAKNIT" me seli në Ferizaj e tani NSh, "Eurometali" me seli në Ferizaj (në likuidim), ka hyrë në procedurën e likuidimit me dt.17.03.2006 dhe paditësi, pranë Autoritetit të Likuidimit (AL), me dt.27.03.2008, pra brenda afatit ligjor, ka parashtruar kërkesën për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën Maj – Tetor 1990 në shumën prej 1.241.00 €, nga NSh "Eurometali" me seli në Ferizaj (në likuidim), e ka bërë me dt.27 Mars 2008 dhe se Autoriteti i Likuidimit pasi që ka bërë vlerësimin e kësaj kërkesë të parashtruar nga paditësi, me Vendimin e tij, GJI057-0193 i dt.16.07.2013, kërkesën e paditësit, e ka refuzuar si të pa vlefshme derisa paditësi, pas pranimit të këtij Vendimi të AL-së, ankesën kundër Vendimit të AL-së, GJI057- 0193 i dt.16.07.2013, pranë DhGJSK-së, e ka paraqitur përmes dërgimit me postë me dt.16.08.2013, pra me ankesën/padinë e përbashkët në lëndën e evidentuar, C – IV – 13 – 1564, pra për këtë arsye, konsiderohet se këtë ankesë kundër Vendimit të AL-së, GJI057- 0193 të dt.16.07.2013, paditësi, e ka bërë brenda afatit ligjor prej 30 ditëve dhe se padisë, paditësi, ia ka bashkangjitur kopjen e Vendimit të kontestuar të AL-së, GJI057- 0193 të dt.16.07.2013 (Vendimi në fjalë nga AKP-ja, në procedurën e likuidimit, është dërguar për palët tek pas dt.17.07.2013, e për këtë shih origjinalin e Vendimit të AL-së, GJI057- 0193 i dt.16.07.2013).

Gjykata, me gjendjen e tillë të shkresave të lëndës, vlerëson se padia/ankesa e paditësit, i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe të afatshmërisë nga dispozitat e lartë cekura ligjore nga neni 36 dhe 74 i Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme lidhur me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në.

Faktet jo kontestuese dhe kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata gjen se nuk është kontestuese në mesë të palëve ndërgjyqëse lidhur me NSh "Eurometali" me seli në Ferizaj (në likuidim), ka ekzistuar raporti juridik i marrëdhënies së punës, dhe se nuk është kontestuese se paditësi, kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën Maj – tetor 1990 në shumën prej 1.241.00 €, e ka bërë me dt.27 Mars 2008, pra brenda afatit për paraqitjen e kërkesave tek AL-ja, për të cilën kërkesa e tij është refuzuar si e pa vlefshme dhe atë me Vendimin, GJI057 - 0193 i dt.16.07.2013 të Autoritetit të Likuidimit dhe atë për shkak të mungesës së provave mbështetëse, se provat e padisë mbeten të pa plota pas kërkesës për prova shtesë, si dhe atë për shkak të parashkrimit të kërkesës në bazë të nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 të AKP-së por kontestuese paraqitet fakti se paditësi, a ka bazë ligjore për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën maj–tetor 1990 në shumë të përgjithshme prej 1.241.00 € nga NSh "Eurometali" me seli në Ferizaj (në likuidim) dhe se këtë kërkesë të tij nga lëmia e marrëdhënies së punës, a e ka bërë të plotë dhe brenda afatit të paraparë ligjor prej 3 vjetëve.

Gjykata konstaton se në rastin konkret, kemi të bëjmë me kërkesat e pa siguruara nga neni 40 par.1 pika 1.7 i Shtojcë së Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), e që flet për Prioritetin e kërkesave dhe interesave, e në të cilin parashihet se :” *Në procedurat e likuidimit të gjitha Kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim. .. kërkesat e pasiguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë*”.

Për çështjen e pagesës së pagave për të një punësuari në një ndërmarrje në nenin 14 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2001/27 i dt.8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (si ligj në

fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës), ka qenë e paraparë se : “*Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të*

shoqëruara me dëftesën e pagesës” kurse në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ...”.

Për ndërprerjen e një kontrate të punës së një të punësuari nga punëdhënësi i tij, në nenin 11 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2001/27 i dt.8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) e që flet për Shkëputjen e kontratës së punës, aty parashihet se : *’Kontrata e punës shkëputet: ... dhe (dh) sipas fuqisë ligjore’* derisa në nenin 14 par.1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2001/2007, ka qenë e paraparë se : *“Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës”* kurse nenin 67 të Ligjit të Punës, Nr. 03/ L-212 të dt.1 nëntor 2010, që flet për Ndërprerjen e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore, aty thuhet se : *’Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: ... me falimentimin dhe likuidimin e ndërmarrjes’* ndërsa në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ...”*

Në bazë të nenit 31 par.1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përcaktohet se: *“Palët, në parashtrësat e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës”* kurse në nenin 36 par.2 pika 1 dhe 2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, parashihet se *“... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme se dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese”* derisa në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (i publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976) dhe si ligj i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë, parashihet se: *“Pagesa e shumës së pagës apo rrogës, ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet”* e për më tepër edhe në nenin 87 të Ligjit të Punës, Nr.03/L – 012, gjithashtu, parashihet afati i njëjtë kohor për parashkrimin e të gjitha kërkesave me para si rezultat i marrëdhënies së punës

Ndërsa në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës , parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”* derisa sipas nenit 7 par.1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Përkitazi me çështjen e pretendimit të të paditurës për parashkrimin e kërkesës së paditësit për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara për shkak të përfundimit të punësimit te NSh-ja në fjalë, gjykata vlerëson se një pretendim i tillë i të paditurës, nuk mund të qëndroj sepse paditësi, për kërkesën e njëjtë, para bërjes së kërkesës me dt.27.03.2008 në procedurën e

likuidimit pranë AL-së, i njëjti që me dt.04.02.1991 në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, së bashku me punëtorët e tjerë, e ka bërë propozimin e përbashkët për realizimin e

të ardhurave personale për periudhën prej 1.5.1990 deri më 31.12.1990 dhe se me këtë veprim, paditësi, e ka ndërprerë afatin e parashkrimit për detyrimin në të holla për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën Maj – tetor 1990 në shumën prej 1.241.00 €, e të cilin kompensim e kërkon nga NSh “Eurometali” me seli në Ferizaj (në likuidim).

Për ndërprerjen e afatit të parashkrimit për një detyrim në të holla e në rastin konkret në emër të kompensimit të pagave të pa paguara, në nenin 388 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr.29/78 me Plotësime dhe Ndryshimet e tij, Nr.39/85, Nr.45/89, dhe Nr.31/93) e që flet për ngritjen e padisë, aty parashihet se : *“Parashkrimi ndërpritet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*.

Po ashtu edhe në nenin 369 të Ligjit të ri mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Nr.04/L-077 të dt.10 maj 2012, që flet për paraqitja e padisë, aty është përcaktuar se: *“Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*. Pra në rastin konkret me bërjen e propozimit të paditësit me dt.04.02.1991 në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, së bashku me punëtorët e tjerë, për realizimin e të ardhurave personale për periudhën prej dt.1.5.1990 deri më dt.31.12.1990, me këtë veprim, paditësi e ka ndërprerë afatin e parashkrimit të detyrimit në të holla - kompensimin e pagave të pa paguara nga marrëdhënia e punës derisa është çështjet tjetër se në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, nuk ka prova se është vendosur për këtë propozim.

Gjykata konsideroj si të drejtë pranimin e kërkesëpadisë së paditësit në emër të kompensimit për pagat e pa paguara në shumë prej 1.241.00 € për periudhën prej muajit Maj – Tetor 1990, si detyrim kryesor derisa e konsideroj si të drejtë edhe pranimin e pjesëshëm të kërkesë padisë për pjesën e kamatën ligjore në lartësi prej 10 %, në shumën prej 124.10 € dhe se ky qëndrim i kësaj gjykate bazohet në dispozitat nga neni 40.1.1.7 i Ligjit nr.04/L-034 për AKP-së që në mënyrë taksative, citon se: *“... Kërkesat e pasiguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”* ” dhe se këto kërkesa dhe interesa të kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 nga i njëjti nen 40, si dhe lidhur pjesën e kërkesëpadisë së paditësit për kamatën ligjore, u zbatua dispozita nga neni 37 par.3 të Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, ku citohet se : *“Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore”*.

Gjykata konsideroj si të drejtë refuzimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë së paditësit lidhur me kërkesën e tij për kamatë vjetore sipas ligjit prej muajit prill 2006 e deri në pagesën definitive, si kërkesë aksesore sepse sipas nenit 37 par.3 të Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, parashihet se : *“Dispozitat e këtij neni kanë efekt superior mbi dispozitat e mundshme kontraktore të kontratave, zgjidhjeve, marrëveshjeve, aktgjykimeve apo rregullimeve tjera të lidhura nga Ndërmarrja apo në emër të saj”*.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të ankuesit lidhur me kërkesën e parashtruar por të njëjtat nuk janë të bazuara me dispozitat ligjore në fuqi në zbatim, andaj kërkesa për pjesën e kërkesëpadisë për shumën e pranuar si dhe për pjesën e refuzuar e me përshkrimin e bërë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, mbetet e refuzuar gjegjësisht ndryshohet vendimi i kontestuar i AL-së.

Vlerësimet përfundimtare të gjykatës.

Gjykata vlerëson se, nuk qëndron qëndrimi i të paditurës, AKP-së, se kërkesa e parashtruesit – paditësit, për kërkesën për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën Maj – Tetor 1990 në shumën prej 1.055.00 € nga NSh “Eurometali” me seli në Ferizaj (në likuidim) e të cilat kërkesë, e që pretendohet dhe të mos jenë paguar, se kjo kërkesë e paditësit, nuk është kërkesë e plotë si dhe është parashkruar e duke iu referuar nenit 36 par.2.1 dhe 2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.03/L – 034 të AKP-së dhe nenit 608 pika 1 të Ligjit për Punën e Bashkuar - LPB (Gazeta zyrtare e RSFJ nr.53/76), pra se ky qëndrim i saj, është i pa bazuar si dhe se AL-ja, nuk i ka zbatuar drejtë dispozitave të cekura ligjore sepse paditësi kërkesën e tij për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën Maj – Tetor 1990 në shumën prej 1.241.00 €, nga NSh “Eurometali” me seli në Ferizaj (në likuidim), pasi që ai, së bashku me të punësuarit e tjerë tek kjo NSh, me bërjen e propozimit të përbashkët me dt.04.02.1991 në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë për realizimin e të ardhurave personale për periudhën prej 1.5.1990 deri më 31.12.1990, me këtë veprim, paditësi, e ka ndërprerë afati e parashkrimit të detyrimit në të holla - kompensimin e pagave të pa paguara nga marrëdhënia e punës si dhe paditësi, ka ofruar provat gjegjëse në mbështetje të kërkesës së tij siç janë Regjistri i dt.07.05.1991, nr.677 i dt.04.07.2002 dhe ai, nr.08 i dt.27.03.2006, i emrave të punëtorëve aktiv për realizimin e borxhit të mbetur pranë NSh, ”Fabrika e këmbyesve të nxehtësisë”, ”FAKNIT” me seli në Ferizaj e tani NSh, “Eurometali” me seli në Ferizaj(në likuidim) për muajt Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor dhe të vitit 1990 e sipas së cilit, NSh “Eurometali” me seli në Ferizaj (në likuidim), përpos të punësuarve të tjerë, edhe paditësit, i ka mbetur borxh për pagat e pa paguara për muajt Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor dhe të vitit 1990.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të japë arsyetime tjera ligjore, andaj, gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – civile, kërkesëpadinë e paditësit, J M nga fshati R i Komunës së Ferizajit, duhet t’ a pranoj pjesërisht si të bazuar dhe Vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL), GJI057- 0193 i dt.16.07.2013, duhet t’ a ndryshoj, si dhe e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit (AL), duhet të obligohet që paditësit, t’ia kompensoj pagat e pa paguara në shumën prej 1,241,00 € për periudhën Maj – Tetor 1990 dhe atë me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit si dhe kamatën ligjore, si kërkesë aksesore në lartësi prej 10 %, për detyrimin kryesor dhe atë në shumën prej 123.10 € derisa duhet të refuzohet pjesërisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit lidhur me kërkesën e tij për kamatë vjetore sipas ligjit prej muajit prill 2006 e deri në pagesën definitive.

Gjykata ka shqyrtuar me kujdes edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por meqë kërkesa e parashtruar i referohet kundërshtimit të të paditurit lidhur me parashkrimin e të drejtës së pretenduar nga paditësi, gjykata nuk e konsideron të arsyeshme të japë shpjegime tjera ligjore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenit 62.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, lidhur me nenin 449, 452, 453, 454 dhe 463 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) dhe Udhëzimit administrativ Nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të KGJK-së përkatësisht nenit 13.3 dhe 13.9, të këtij udhëzimi, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe që pala e paditur, t'i bart shpenzimet gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore sepse në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), është përcaktuar se vetëm palës së suksesshme në procedurë (palës që e fiton gjykimin), i takon kompensimi i shpenzimeve gjyqësore dhe se paditësi, është i përfaqësuar nga avokati ndërsa në këtë çështje kontestimore, paditësi, e ka fituar pjesërisht procesin gjyqësor, andaj gjykata ka vendosur që pala e paditur si palë në procedurë, t'i bart shpenzimet gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2022:273606, 09.11.2023

**Gjykatësi
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).